



TERMAT E REFERENCËS

PËR

**ZGJERIMIN E INFRASTRUKTURËS IT, RITJEN E NIVELIT TË SIGURISË
DHE ADMINISTRIMIN E QENDËRZUAR TË AKSESIT NË RRJETET E
KOMUNIKIMIT NË KESH SHA**

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

HISTORIKU I VERSIONEVE DHE NDRYSHIMEVE TË DOKUMENTIT

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
		1.0	Përpilimi origjinal i TORs
		1.0	Përpilimi origjinal i TORs

NËNSHKRIMET MIRATUESE

Përgatiti:

<Nënshkrimi>

Përgatiti:

<Nënshkrimi>

Kontrolloi:

Mbikqyrësi i Projektit

<Nënshkrimi>

Përmbajtja	
FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	2
HISTORIKU I VERSIONEVE DHE NDRYSHIMEVE TË DOKUMENTIT	2
NËNSHKRIMET MIRATUESE	2
1. Hyrje	5
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues	5
1.2. Historiku	5
1.3. Situata Aktuale	5
2. Objektivat, risqet, qëllimi dhe rezultatet e pritura	6
2.1 Objektivi i Përgjithshëm	6
2.2 Qëllimi	7
2.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori	8
2.4 Supozimet e Projektit	9
2.5 Rrisqet	9
2.6 Hapsira gjeografike dhe vendodhja	9
3. Detyrat specifike	9
3.1. Përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit	10
3.2. Ngritja e grupeve të punës nga të dyja palët e interesuara	10
3.3. Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave	10
3.4. Realizim punime civile jo të specializuara	10
3.5. Spostim të pajisjeve ekzistuese dhe riorganizim të dhomës së serverave	11
3.6. Furnizim dhe vendosje i pajisjeve të reja në dhomën e servereve dhe dhomën teknike	11
3.7. Dizenjimi dhe përcaktimi i infrastrukturës së rrjetit	12
3.8. Implementimi i zgjidhjes wireless	12
3.9. Implementimi i zgjidhjes së sigurisë	12
3.10. Integrimi me infrastrukturën ekzistuese	12
3.11. Përgatitja e manualeve udhëzuese dhe trajnimi i përdorueseve për politikat e sigurisë	12
3.12. Raportimi i çdo faze të projektit	12
3.13. Dokumentimi përfundimtar dhe marrja në dorëzim	12
4. Logjistika dhe koha	13
4.1. Vendndodhja	13
4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	13
5. Raportimi	13
5.1. Kërkesat e Raportimit	13
5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	13
6. Planifikimi i buxhetit për levrimin e projektit	14
7. Kërkesat Funktionale	14
7.1. Funkcionalitete dhe bllokskema të infrastrukturës	16
7.2. Kërkesat funksionale për zgjidhjen teknike mbi kontrollin e aksesit në rrjet	16
7.3. Kërkesat funksionale për përmirësim të rrjetit LAN të HQ	18
7.4. Kërkesat funksionale për zgjidhjen teknike mbi Sistemin e menaxhimit dhe supervizimit për pikat e aksesit radio	18
7.5. Kërkesat funksionale për zgjidhjen teknike mbi rrjetin e aksesit	19
7.6. Shërbimet e kërkuara	20
8. Specifikimet Teknike	20
8.1. Pikë aksesi radio	21

8.2.	Platformë për kontrollin e pikave të aksesit radio (Virtual)	22
8.3.	Switch aksesi	24
8.4.	Platformë Sigurie për kontrollin e aksesit në rrjet (Virtual)	25
8.5.	Derë zjarrduruese.....	27
8.6.	Dysheme teknologjike	27
8.6.1.	Pllakat	27
8.6.2.	Aksesorët e ajrimit	27
8.6.3.	Rampë ose Shkallë	28
8.7.	Sistemi i shuarjes së zjarrit	28
8.7.1.	Paneli i kontrollit.....	28
8.7.2.	Detektorët e tymit dhe të temperaturës	28
8.7.3.	Butonat e aktivizimit dhe ndalimit manual	29
8.7.4.	Pajisjet e sinjalizimit	29
8.7.5.	Sprucatorët	29
8.7.6.	Cilindri dhe agjenti i shuarjes	29
8.8.	Sistemi i monitorimit	30
8.9.	Sistemi i kontrollit të aksesit.....	31
8.10.	Sistemi CCTV	31
8.11.	Sistemues kabllorsh horizontale.....	31
8.12.	Sistemues kabllorsh vertikale.....	31
8.13.	Patch Cord OM5	31
8.14.	Patch Cord ethernet Cat.6A	32
9.	Dorëzimi i dokumentacionit	32

1. Hyrje

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a), është një shoqëri tregtare aksionere shtetërore e integruar vertikalisht dhe është prodhuesi kryesor dhe më i rëndësishëm i energjisë elektrike në Shqipëri, që administron dhe operon hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (HEC-Fierzë, HEC-Koman, HEC-Vau i Dejës) të cilët janë të rëndësishëm së veçantë për ekonominë e vendit.

1.2. Historiku

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare synon në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë infrastrukturën e aksesit të rrjetit internet si dhe të rrisë nivelin e sigurisë e administrimit e aksesit në rrjetat e komunikimit në funksion të miradministrimit dhe rritjes së efikasitetit të korporatës. Për këtë qëllim gjatë viteve janë kryer investime të rëndësishme në këtë sektor.

1.3. Situata Aktuale

Në ditët e sotme është rritur shumë përdorimi i pajisjeve mobile siç janë Laptop, tableta, telefona smart, etj, nga përdorues të organizatës apo edhe vizitorë. Për rrjedhojë është rritur nevoja për lidhjen e këtyre pajisjeve në rrjet me qëllim shkëmbimin e informacionit. Një pjesë e këtyre pajisjeve janë legjitime për të shfrytëzuar informacioni i cili ruhet në infrastrukturën e brendshme të sistemeve ku kërkohet një nivel i lartë i sigurisë, ndërsa për disa të tjera është e nevojshme vetëm akses i sistemeve në perimetrat DMZ apo vetëm thjesht akses në Internet. Lidhja e këtyre pajisjeve në rrjet shton edhe rrezikun që këto pajisje mund të induktojnë në rrjetin e brendshëm. Përdoruesit mund të lidhin pajisje të ndryshme në rrjet siç mund të jenë pikat e aksesit radio apo pajisje mobile personale pa dijeninë e administratorëve të rrjetit duke krijuar në këtë mënyrë pika aksesit vulnerabël të cilat mund të shfrytëzohen mjaft lehtë nga keqdashës. Aktualisht në infrastrukturën e rrjetit nuk ka vizibilitet dhe kontroll mbi pajisjet të cilat lidhen në rrjetin kabllor dhe radio. Për rrjedhojë nuk është e dukshme në atë çka po ndodh në rrjet, si p.sh. kush është i lidhur, cilat aplikacione janë instaluar dhe ekzekutuar. Nuk ka informacion mbi identitetet e përdoruesve dhe pajisjeve, kërcënimet dhe dobësitë të cilat ekzistojnë në rrjet në mënyrë që të mund të identifikohen, kontrollohen dhe të korrigjohen kërcënimet sa më shpejt të jetë e mundur.

Shpesh here nevojitet të mundësohet akses në rrjet për pajisjet e vizitoreve. Mënyra e qasjes në rrjet për vizitorët kryhet në po të njëjtattribute si përdoruesit e brendshëm duke mos patur mundësi për ti diferencuar dhe për ti dhënë aksese të veçanta në rrjet. Nëse pajisjet e vizitoreve janë të infektuar dhe qasen në të njëjtin rrjet me përdoruesit e brendshëm, kjo mund të shkaktojë probleme serioze në rast se nuk ka një mekanizëm i cili arrin të parandalojë këtë efekt negativ. Në infrastrukturën aktuale nuk ka një sistem automatik i cili të mund të garantojë aksesin e vizitoreve në rrjet. Meqenëse sasia e informacionit që shkëmbehet në ditët e sotme është e lartë, nevojitet një infrastrukturë aksesit radio e cila ofron kapacitetet e duhura për të suportuar ngarkesën e trafikut. Infrastruktura ekzistuese bazohet mbi protokolle të vjetërsuar radio dhe nuk garanton kapacitetet fizike për të transferuar throughput të lartë. Për të zgjidhur problemet e evidentuara është e nevojshme implementimi i një zgjidhje teknike e cila mund të bllokojë aksesin në rrjet për ato

pajisje të cilat nuk janë në përputhje me politikat e sigurisë ose t'iu japë pajisjeve akses të limituar me qëllim sigurimin e rrjetit nga risqet që mund të injektohen. Gjithashtu kjo zgjidhje duhet të garantojë kapacitete teknike për të mundësuar transferimin e shpejte të informacionit.

Gjithashtu Korporata Elektroenergjitike Shqiptare ka një dhomë serveresh ekzistuese në të cilën janë të instaluar:

- 4 kabinate rack me permasa 42U 600 mm x 1000 mm
- 3 x sisteme ftohje precision cooling
- 1 x sistem shuarje zjarri
- 1 x UPS tower
- 1 x sistem CCTV dhe kontroll aksesi

Dhoma është e pajisur me dysheme teknologjike. Dimensionet e dhomës së serverave janë 274 cm x 570 cm. Rack në dhomën e serverave janë të pozicionuar në mesin e dhomës, dhe janë të pozicionuar në trajte jo të rregullt. Nderlidhja e paisjeve me njera tjetren është realizuar me patch corda bakri (ethernet) dhe fibër optike, të pa organizuara, të pa-etiketuara dhe pa përdorur organizues kabllorsh. Pllakat e dyshemese teknologjike, janë amortizuar duke përbërë rrezik për aktivitetet në vijim (instalime dhe mirembajtje).

2. Objektivat, risqet, qëllimi dhe rezultatet e pritura

2.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është implementimi i një zgjidhje të re të infrastrukturës wireless e cila do të bëjë upgrade të ekzistueses duke ofruar funksionalitete dhe veçori të reja. Një tjetër objektivi është implementimi i një zgjidhje të re për të zhvilluar me tej politikat e sigurisë të infrastrukturës wired si dhe wireless e cila do duhet të integrohet me infrastrukturën ekzistuese. Gjithashtu, duhet të realizohet integrimi me rrjetin ekzistues për pajisjet Layer 2 si dhe Layer 3. Për efekt të zgjerimit të infrastrukturës IT fizike, duhet të realizohet riorganizimi i dhomës ekzistuese të serverave nëpërmjet zgjerimit me një ambient tjetër shtesë, ngjitur me dhomën ekzistuese. Ambienti i ri, do të përdoret si dhomë teknike ndërsa server room aktual do të përdoret vetëm për “hostimin” e pajisjeve IT.

Në dhomën teknike duhet të vendosen pajisjet si mëposhtë:

- 3 x sisteme ftohje precision cooling (transferim i sistemit ekzistues)
- 1 x UPS tower (transferim i UPS ekzistues)
- 1 x sistem shuarje zjarri (furnizim dhe vendosje i një sistemi të ri)
- 1 x sistem CCTV dhe kontroll aksesi (furnizim dhe vendosje i sistemeve të reja)

Sistemet e ftohjes, dhe UPS janë momentalisht të instaluar dhe funksional brenda dhomës së serverave, dhe duhet të transferohen në ambientin e ri, dhomë teknike. Njesite e jashtme të kondicionereve nuk do të spostohen. Ato do të qëndrojnë në vendet aktuale. Duhet të kryhet lidhja e njesive të jashtme me njesite e brendshme respektive në pozicionet e reja në dhomën teknike (duhet të bëhet zgjatim i tubave të bakrit nga pozicioni aktual i njesive të ftohjes deri tek pozicioni i ri). Paneli elektrik i dhomës së serverave nuk do të ndryshojë, por linjat elektrike të furnizimit me energji të sistemeve ftohese do të instalohen nga paneli ekzistues deri tek pozicioni i ri i njesive ftohese). Instalimet e brendshme elektrike në dhomën aktuale të serverave nuk do të ndryshojnë. Duhet të instalohen vetëm linjat hyrje/dalje të UPS nga pozicioni i ri në dhomën teknike, deri në panelin elektrik ekzistues. Ambienti i ri, i cili do të përdoret si dhomë teknike për UPS dhe sistemin

e ftohjes, ndodhet në dhomën ngjitur me dhomën ekzistuese të serverave. Dimensionet e këtij ambienti janë 427 cm x 337 cm, dhe lartësi 2.8 m (nga dyshemeja deri në tavan). Ky ambient nuk është i pajisur me dysheme teknologjike.

2.2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate është gjetja e një kontraktori me përvojë, i cili do të ofrojë një zgjidhje profesionale dhe të qëndrueshme, në funksion të kërkesave të mëposhtme të KESH SH.A. Qëllimi kryesor i këtij projekti është zëvendësimi i infrastrukturës aktuale me një infrastrukturë wireless të re bazuar mbi teknologjinë WIFI-6, e cila duhet të mundësojë performancë me të mire, kapacitet të lartë dhe funksione të reja duke ofruar një eksperiencë me të mire për përdoruesit e rrjetit wireless.

Disa nga veçoritë kryesore që duhet të ofrojë zgjidhja teknike për infrastrukturën wireless janë:

- Rritje të sigurisë në ndërfaqen wireless, për përdoruesit dhe pajisjet.
- Integrimi i Infrastrukturës së re Wireless me sistemin e sigurisë për kontrollin e aksesit për autentifikim të sigurt për të gjitha Wireless SSID.
- Implementim i kësaj infrastrukture me wireless controller të cilët mund të instalohen në infrastrukturën ekzistuese.
- Akses Point-e të cilët ofrojnë shume veçori të reja dhe mundësi për tu bere upgrade në të ardhmen.
- Mundësi për tu automatizuar duke përdorur një set të gjere të ndërfaqeve standarte API.

Gjithashtu, ky projekt duhet të përmirësojë sigurinë e Infrastrukturës në tërësi, nëpërmjet dhe implementimit të një sistemi të sigurisë për kontrollin e aksesit në rrjet.

Vec të tjerash duhet të mundësohet:

- implementimi i politikave BYOD – Bring Your Own Device,
- Integrimi i Infrastrukturës aktuale AD me zgjidhjen e propozuar mbi sistemin e sigurisë për kontrollin e aksesit,
- prezantimi i politikave të sigurisë për VPN users
- prezantim dhe konfigurim i politikave të sigurisë për përdoruesit e rrjetit kabllor (Wired users) sipas departamenteve përkatëse,
- autentifikim i sigurt i sensoreve (apo IoT Devices),
- implementimi i portaleve të autentifikimit të sigurt Guest dhe Sponsor përmes “HTTPS redirect” etj.

Projekti duhet të mundësojë:

- performancë me të mire,
- nivel sigurie të lartë,
- koleksionim i device Information përmes funksionalitetit të sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit për menaxhimin e aseteve të KESH,
- autentifikim i përdoruesave Guest dhe atyre të lidhur me AD përmes “HTTPS-SSL enabled portals”, BYOD portals për përdoruesit që sjellin pajisjet e tyre në zyrat e korporatës
- autentifikim i sigurt për përdoruesit Guest përmes Guest portal

Disa nga veçoritë kryesore që duhet të mundësojë sistemi i sigurisë për kontrollin e aksesit janë si me poshtë:

- Vizibilitet i aseteve të kompanisë
- Aksese të ndryshme sipas kontentit
- Aplikim apo zbatim i politikave të sigurisë mbi aksesin

-
- Metoda aksesi për përdoruesit Guest me anë të “Guest Portals & Sponsor Portals”
 - Funkcionalitet BYOD
 - Verifikim i automatizuar mbi pajtueshmërinë e pajisjeve
 - Politika sigurie aksesi
 - TrustSec Group Based Policy – Markim i paketave sipas sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit
 - Auditim i pajisjeve
 - Koleksionim informacioni rreth pajisjeve të përdorura në korporatë – “Profiling”
 - Vendosja e politikave të detajuara të sigurisë në nivel aplikacioni apo rregjistrash – “Posture Services”

Tjetër qëllim i projektit është si me poshtë:

- Lirim i hapësirave në dhomën ekzistuese të serverave, në mënyrë që të lejojë shtimin e rack dhe paisjeve të reja. Momentalisht është e pamundur që në dhomën e serverave të shtohet një rack i ri për vendosjen e paisjeve të reja.
- Riorganizim i rack-eve ekzistues në server room, në mënyrë që të rritet eficensa e sistemit të ftohjes, e cila automatikisht përkthehet në me pak konsum energjie elektrike.
- Sistemimi i paisjeve nëpër racke dhe etiketimin e tyre, për të lehtësuar operimin, mirembajtjen dhe ndryshimet që mund të nevojiten.
- Sistemimi i kabllimeve ndërmjet rackeve, lidhja e paisjeve me patch corda baker (ethernet) dhe fibër optike me patch panelet përkatëse, si edhe etiketimet e të gjitha patch cordave, për të lehtësuar operimin, mirembajtjen dhe ndryshimet që mund të nevojiten.
- Ndarje në dy ambiente të dedikuara të pajisjeve IT dhe pajisjeve teknike. në server room duhet të jenë të instaluar vetëm pajisjet IT (servera, storage, pajisje telekomunikacioni), ndërsa në dhomën teknike duhet të jenë të instaluar sistemet teknike që garantojnë kushtet operacionale të pajisjeve IT.

2.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Rezultatet që priten të arrihen gjatë zbatimi të kësaj kontrate janë si me poshtë:

- Përbushja e të gjitha kërkesave funksionale dhe teknike të paraqitura nga KESH në këtë dokument brenda afatit kohor.
- Dokumentim i plotë i çdo faze të projektit dhe raportim të autoriteti kontraktues
- Implementimin e AP-ve wireless dhe një kontrolleri wifi për menaxhimin e tyre.
- Implementimin e sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit me 2 node për të arritur disponueshmeri të lartë duke ndare shërbimet midis nodeve në Active dhe Standby.
- Implementimin e funksionalitetit të RADIUS për pikat e mëposhtë:
 - Wired 802.1X Authentication/Authorization/Auditing.
 - Wireless 802.1x Authentication/Authorization/Auditing.
 - Implementim i BYOD për pajisjet Wireless.
 - Aktivizim i politikave BYOD për përdoruesit që sjellin pajisje të reja On-premise.
 - Implementim i “Profiling” i cili të bëjë të mundur raportimin e të dhënave të detajuara në sistemin e sigurisë për kontrollin e aksesit Dashboards për onboarded devices.
 - Guest Access përmes Guest portals dhe Sponsor Portals.
 - Implementimi i autentikimit bazuar mbi MAC për pajisjet e vjetra.
 - Implementimi i “Dual factor authentication” përmes sistemit të sigurisë për kontrollin e aksesit për përdoruesit e lidhur nga VPN.
- Realizim punime civile jo të specializuara sipas detajeve të mëposhtme

-
- Realizim punime për spostim të paisjeve ekzistuese dhe riorganizim të dhomës së serverave
 - Implementim sistem i detektimit dhe fikjes së zjarrit
 - Implementim sistem i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit
 - Implementim sistem akses kontrolli
 - Implementim sistem i videomonitorimit CCTV

2.4 Supozimet e Projektit

Supozimet kryesore për suksesin e Projektit:

- Kontraktimi i nje kontraktori me eksperiencën e nevojshme në implementimin dhe upgrade të zgjidhjeve të infrastrukturës wireless duke ofruar funksionalitete dhe veçori të reja si dhe në implementimin e zgjidhjeve të reja të politikave të sigurisë të infrastrukturës wired dhe wireless.
- Kontraktimi i nje kontraktori me eksperiencën e nevojshme në implementimin dhe zgjerimin e infrastrukturës IT
- Angazhim dhe mbeshtetje e plotë nga personat e përfshirë në zbatimin e kontrates;
- Qasje e plotë dhe e detajuar në infrastrukturën TIK aktuale në ambientet e godines së zyrave qendrore të KESH sha.

2.5 Rrisqet

Rreziqet kryesore që duhen marre në konsiderate përfshijne:

- Disponueshmeria e informacioneve mbi gjendjen e infrastrukturës aktuale
- Integrimi me infrastrukturën ekzistuese
- Feedback objektiv dhe i sakte nga personeli i KESH i përfshirë në zbatimin e kontrates
- Alokimi i burimeve njerezore të nevojshme për implementimin e ketij projekti

2.6 Hapsira gjeografike dhe vendodhja

Shërbimet dhe produktet e kërkuara do të lëvrohen dhe implementohen në Zyrat Qendrore të KESH SHA, Tirane.

3. Detyrat specifike

Ne kuader të qëllimit kryesor të ketij projekti, i gjithë projekti do të ndërtohet mbi detyrat e mëposhteme:

1. Përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit
2. Ngritja e grupeve të punës nga të dy palët e interesuara
3. Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave
4. Planifikimi dhe realizimi i punimeve për zgjerimin e infrastrukturës IT
5. Dizenjimi dhe përcaktimi i infrastrukturës së rrjetit
6. Implementimi i zgjidhjes wireless
7. Implementimi i zgjidhjes së sigurisë
8. Integrimi me infrastrukturën ekzistuese

-
9. Përgatitja e materialeve udhëzuese dhe trajnimi i përdoruesve për politikat e sigurisë
 10. Raportimi i çdo faze të projektit të menaxheret e projektit ose ndjekësit e kontratës.
 11. Dokumentimi dhe marrja në dorëzim e zgjidhjes

3.1. Përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit

- Planifikimi i burimeve njerezore dhe materialeve të nevojshme për realizimin e projektit.
- Realizimi i nje plani të detajuar mbi zhvillimin e projektit dhe implementimit të zgjidhjes teknike.
- Realizimi i dokumentacionit teknik ku të detajohet dhe percaktohet me saktësi skema dhe arkitektura e zgjidhjes së propozuar për implementimin e zgjidhjes teknike për të qene sa me e pershtatur me nevojat aktuale.

3.2. Ngritja e grupeve të punës nga të dyja palët e interesuara

- Identifikimi i specialisteve të punës brenda KESH sh.a dhe krijimi i grupit të punës.
- Identifikimi i specialisteve të punës nga kontraktori sipas kërkesave teknike.
- Koordinimi dhe shkembimi i kërkesave midis dy grupeve të punës

3.3. Mbledhja, specifikimi dhe dokumentimi i analizës së kërkesave

- Mbledhja e kërkesave funksionale dhe teknike nga departamenti IT i KESH sh.a sipas kërkesave teknike.
- Analizimi i kërkesave.
- Dokumentimi i kërkesave dhe konfirmimi në grupin e punës

3.4. Realizim punime civile jo të specializuara

1. Zgjerim i derës ekzistuese të ambientit të ri, që do të perdoret si dhome teknike. Ky ambjent momentalisht është me derë me gjerësi 90 cm. Duhet të hiqet dera ekzistuese dhe të vendoset një derë e re zjarrduruese me gjerësi 120 cm.
2. Patinim dhe lysterje e mureve në ambientin e ri dhe në dhomën ekzistuese të serverave.
3. Trajtim i dyshemese në ambientin e ri (lysterje me boje kunder lageshtise dhe pluhurit).
4. Ri-nivelim i dyshemese teknologjike ekzistuese në dhomën e serverave dhe pastrimi i saj.
5. Instalim i dyshemese teknologjike në ambientin e ri. të dy dhomat jane në të njejtin nivel, dhe dyshemeja që duhet të instalohet në ambientin e ri duhet të jete në të njejten lartësi me dyshemene e dhomës ekzistuese të serverave. Dyshemeja ekzsituese është në lartësine 40 cm e perfunduar.
6. Instalim i sistemit të ndricimit në ambientin e ri. Vendorsja e kater ndricuesve LED 60 cm x 60 cm me kase të jashtme, direkt në tavan.
7. Zëvendësim i ndricuesve ekzistues (neona fleuroshente) me kater ndricues LED me dimensione 60 cm x 60 cm në dhomën e serverave.
8. Mbyllja e dritës së ambientit për të arritur standartin e kërkuar

3.5. Spostim të pajisjeve ekzistuese dhe riorganizim të dhomës së serverave

1. Spostim i tre njesive të sistemit të ftohjes ekzistues në ambientin e ri.
Njesite e brendshme ekzistuese të sistemit të ftohjes duhet të vendosen në dhomën teknike mbi dyshemene teknologjike, ngjitur me murin ndares midis dhomës së serverave dhe dhomës teknike. Nen dyshemene teknologjike, në murin ndares midis dhomës së serverave dhe dhomës teknike, duhet të hapen 3 zgavra ajri me dimensione 30 x 60 cm, që të lejojnë ajrin e ftohte që fryhet nen dysheme nga njesite e sistemit të ftohjes të kalojë në dhomën e serverave. Ndërsa mbi njesite e sistemit të ftohjes, në murin ndares midis dhomës së serverave dhe dhomës teknike, duhet të hapen 3 zgavra ajri me dimensione 30 cm x 60 cm që të lejojnë thithjen e ajrit të ngrohte që çlirohet nga dhoma e serverave. Zgavrat e hapura duhet të pajisjen me grila ajrimi murale. Njesite e jashtme të sistemit të ftohjes nuk duhet të spostohen, por do të zgjaten vetëm tubat e bakrit nga dhoma ekzistuese e serverave deri tek pozicioni i ri ku do të instalohen njesite e ftohjes në dhomën teknike. Gjithashtu linjat elektrike për furnizimin me energji të njesive të jashtme nuk duhet të nderrohen. Duhet të instalohen të reja vetëm linjat e furnizimit për 3 njesite e brendshme nga paneli elektrik ekzistues deri tek pozicioni i ri i njesive të brendshme në dhomën teknike.
2. Spostim i UPS ekzistues nga dhoma e serverave në ambientin e ri në dhomën teknike. Paneli elektrik ekzistues i dhomës nuk duhet të ndryshohet. Duhet të behen të reja vetëm linja e hyrjes dhe linja e daljes nga paneli elektrik ekzistues deri tek pozicioni i ri i UPS.
3. Ripozicionim i 4 kabineteve ekzistues në dhomën e servereve ekzistuese. Kabllimet janë realizuar nen dysheme, dhe ka rezerva të mjaftueshme për levizje të kabineteve. Pozicionimi i kabineteve brenda dhomës ekzistuese duhet të behet në një formë të tillë, që të optimizohet ftohja e pajisjeve të instaluar në kabinete, të rritet eficensa e sistemit të ftohjes, e cila automatikisht ndikon në uljen e konsumit të energjisë elektrike. KESH sh.a, kërkon riorganizimin e kabineteve. Tre prej kabineteve ekzistuese janë me lartësi 42U, 600 mm x 1000 mm, dhe një kabinet ekzistues është me dimensione 42U, 800 mm x 1000 mm. Kabinetet ekzistuese janë me dyer të perforuara para dhe mbrapa. Dyert mbrapa janë vertikalisht të ndara. Kapaket anesore të kabineteve mund të hiqen. Kabinetet kanë shina vertikale të cilat lejojnë bashkimin e kabineteve me njëri tjetrin dhe kanë kembe të rregullueshme të cilat mund të hiqen për tu mbeshetur direkt në dyshemene teknologjike. Operatorët ekonomike, janë të lire të ofrojnë zgjidhjen e tyre, duke përdorur çfaredo lloj aksesori që ata shohin të nevojshme, duke pasur parasysh që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
 - Ne dysheme teknologjike, para rreshtit të kabineteve të ketë grila ajrimi që lejojnë fryrjen e ajrit të ftohte përpara rack-eve. Grilat duhet të kenë permasa 60 cm x 60 cm.
4. Riorganizim i kabllimeve brenda kabineteve ekzistuese. Sistemim i patch cordave të bakrit (ethernet) dhe të patch cordave fibër optike. Instalim i sistemuesve vertikal dhe horizontal në secilin prej kabineteve. Etiketim i të gjitha kablllove.

3.6. Furnizim dhe vendosje i pajisjeve të reja në dhomën e servereve dhe dhomën teknike

1. Zëvendësim i dorezave dhe bravave të rack-eve ekzistues, me doreza rrotulluese të pajisura me lexues RFID dhe me brave elektrike/magnetike.
2. Instalim i një sistemi shuarje zjarri me agjent të paster në ambientin e ri (dhoma teknike).
3. Instalim i një sistemi monitorimi për të dy ambientet, dhomën e serverave dhe dhomën teknike.
4. Instalim i sistemit CCTV dhe kontrollit të aksesit në dhomën teknike.
5. Instalim i kontrollit të aksesit në dhomën e serverave dhe në raket e dhomës së serverave

3.7. Dizenjimi dhe përcaktimi i infrastrukturës së rrjetit

- Analizimi i kërkesave për infrastrukturën e rrjetit
- Paraqitja në mënyrë skematike e infrastrukturës së rrjetit.
- Dizenjimi i skemes teknike dhe logjike të rrjetit.
- Përgatitja e ambienteve të punës.

3.8. Implementimi i zgjidhjes wireless

- Implementimi i zgjidhjes, në perputhje me kërkesat teknike të percaktuara, duke respektuar standardet dhe praktikat me të mira për implementimin e rrjetave wireless.

3.9. Implementimi i zgjidhjes së sigurisë

- Implementimi i sigurisë së infrastrukturës kabllore si dhe wireless, nëpërmjet dizenjimit dhe Implementimit të një sistemi të sigurisë për kontrollin e aksesit.

3.10. Integrimi me infrastrukturën ekzistuese

- Vlerësim i infrastrukturës ekzistuese të rrjetit dhe sistemeve në ambientet e godines qendrore të KESH sha.
- Integrimi me infrastrukturën ekzistuese
- Integrimi me rrjetin ekzistues për pajisjet Layer 2 si dhe Layer 3.

3.11. Përgatitja e manualeve udhëzuese dhe trajnimi i përdorueseve për politikën e sigurisë

- Identifikim i nevojave për trajnim dhe materialeve të nevojshme për trajnim.
- Organizim i trajnimeve për administratoret e sistemit.
- Dorëzimi i manualeve të përdorimit.

3.12. Raportimi i çdo faze të projektit

Kompleksiteti dhe rëndësia e implementimit të kësaj zgjidhjeje teknike do të kërkojë një koordinim dhe bashkepunim të ngushtë midis kontraktorit dhe specialistëve të KESH sh.a. për të patur koherencë në vendimmarrje dhe zhvillim dhe për të eliminuar keqkuptimet që mund të lindin, do të duhet që çdo fazë e zbatimit të projektit të ndiqet nga përfaqësuesit e të dy paleve të shoqeruara me raportet përkatëse.

3.13. Dokumentimi përfundimtar dhe marrja në dorëzim

- Testimi i zgjidhjes teknike sipas planit dhe dokumentimi i rezultateve.

-
- Dokumentimi i zgjidhjes teknike të aplikuar
 - Dorëzimi i dokumentacioneve përfundimtare dhe fatures
 - Marja në dorëzim nga autoriteti kontraktor
 - Mbyllja e projektit

4. Logjistika dhe koha

4.1. Vendndodhja

Takimet e punës, instalimet dhe konfigurimet do zhvillohen në Zyrat Qendrore të KESH sh.a, Tirane. KESH sh.a do të ofrojë akseset e nevojshme si dhe mbeshetje logjistike duke përfshirë sallat e takimit.

4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontrates dhe periudha e zbatimit të kontrates do të jete katër (4) muaj nisur nga kjo datë.

5. Raportimi

5.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqese raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe, në origjinal dhe të pakten një (1) kopje:

- **Raporti Fillestar** në raport Kontraktuesi duhet të pershkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështiresi të pritura ose të hasura. Kontraktuesi duhet të vazhdoje me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dergoj komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** në këtë dokument do të duhet të përfshihet informacion i detajuar në implementimin e zgjidhjes, licencat e përdorura, informacion mbi sigurinë e sistemit, informacionet shtese të nevojshme, etj. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se dy javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar përfshin inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Përmbyllja e seciles nga fazat e projektit dokumentohet me procesverbal të përpiluar nga ofruesi i shërbimit dhe të firmosur nga punonjësit përgjegjës të të dy palëve.

5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raportet e përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet ndjekësit të projektit të identifikuar në kontratë. Ndjekësi i projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Raporti do të dorezohet:

- Ne forme elektronike me email
- Me shkrim i firmosur nga ndjekesit e projektit për të dyja palët.

6. Planifikimi i buxhetit për levrimin e projektit

Nr.	Emërtimi	Njesia	Sasia	Cmimi
1	F.V Punime civile jo të specializuara	Set	1	
2	FV. Derë zjarrdurese	Cope	1	
3	FV. Dysheme teknologjike	m2	14	
4	FV. Punime për spostim të paisjeve ekzistuese dhe riorganizim të dhomës së serverave (spostimi i 3 njesive ftohese, zgjatimi i tubave të bakrit, linjave të furnizimit me energji, spostimin e UPS, linjave hyrje/dalje të UPS, ripozionimin e kabineteve)	Set	1	
5	F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes së zjarrit (perfshi panelin e kontrollit, detektorët e tymit dhe të temperaturës, sirenat, cilindrin me agentin e shuarjes, pajisjet e sinjalizimit (Alarmit), butonat e aktivizimit dhe ndalimit manual, tubat dhe nozolat e shkarkimit, Valvulat e shkarkimit, sprucatorët etj).	Set	1	
6	F.V Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit	Set	1	
7	F.V. Sistem akses kontrolli për dert e dy dhomave dhe për kabinetet (Kontrollera, lexues RFID, brava elektrike / magnetike...etj)	Set	1	
8	FV. Sistem i videomonitorimit CCTV	set	1	
9	F.V. Patch corda bakri Cat.6A, 0.5m	cope	96	
10	F.V Patch corda optike OM5 duplex LC-SC, 1m	cope	48	
11	F.V Sistemues kabllosh horizontal me kapak 1RU	cope	16	
12	F.V Sistemues kabllosh vertikal me kapak	cope	8	
13	F.V Wireless Access Point	cope	12	
14	F.V Kontroller Wireless	set	1	
15	F.V Switch Akses	cope	2	
16	F.V Platformë Sigurie për akses kontroll (Virtual)	set	2	
17	Implementim projekti		1	
Totali (Lek me tvsh)				

7. Kërkesat Funktionale

Per të zgjidhur problemet e evidentuara është e nevojshme implementimi i nje zgjidhje teknike e cila mund të bllokojë aksesin në rrjet për ato pajisje të cilat nuk jane në perputhje me politikat e sigurisë ose t’iu jape pajisjeve akses të limituar me qëllim sigurimin e rrjetit nga risqet që mund të injektohen. Gjithashtu kjo zgjidhje duhet të garantoje kapacitete teknike për të mundesuar transferimin e shpejte të informacionit.

Zgjidhja teknike do të fokusohet në dy objektiva kryesore si me poshtë:

- Rritja e sigurisë për kontroll të aksesit në rrjetit për zyrat qendrore
- Përmirësim i rrjetit radio për zyra qendrore

Kërkesa kryesore është implementimi i nje infrastrukturë e cila zbaton ose detyron politika sigurie për të gjithë përdoruesit e rrjetit gjatë fazes së aksesit në rrjetin kabllor ose radio. Gjithashtu, e rëndësishme për përmirësimin e rrjetit radio është implementimi i nje infrastrukturë me kapacitet dhe funksionalitete të përmirësuar për përdoruesit në ambientet e zyrave qendrore të KESH. Rritja e sigurisë në aksesin e rrjetit dhe përmirësimi i infrastrukturë së rrjetit radio duhet të fokusohet në disa komponente kryesore të pershkruar si me poshtë. Per rritur sigurinë dhe kontrollin e aksesit në rrjet, kerkohet nje zgjidhje e avancuar për kontrollin e aksesit në rrjet i cili do të implementoje politikat e sigurisë në rrjetin kabllor dhe ate radio. Kjo zgjidhje duhet të arrije të aplikojë rolet e Autentifikimit, Autorizimit dhe ate të mbajtjes së llogarive. Gjithashtu zgjidhja teknike duhet të kryejë raportim në lidhje me përdoruesit të cilët aksesojne pajisjet e rrjetit, cfare komandash apo ndryshimesh behen dhe kohen kur kryehen keto veprime. për të patur dijeni në lidhje me perdruesit e brendshem të organizates, sistemi duhet të ketë mundësi për tu integruar me Windows Active Directory.

Zgjidhja teknike duhet të bazohet mbi protokollin 802.1x dhe për ato pajisje të cilat nuk e suportojne këtë protokoll sic mund të jenë IP printer, etj, të ketë mekanizma ku të kryhet procesi i autentifikimit si psh, me ane të MAC adresave. Zgjidhja teknike duhet të ofrojë mundësinë për të kontrolluar lidhjen e pajisjeve personale të përdoruesave, ku përdoruesit e brendshem ose ata jashte organizate të mund të sjellin pajisjet e tyre personale si psh laptop, telefona smart, etj, dhe serisht të marrin atributet e duhura për të aksesuar burimet apo sistemet në infrastrukturën e brendshme. Kjo zgjidhje duhet të mundësojë funksion profilizimi ku me ane të te cilit të identifikoje dhe klasifikojë pajisjet të cilat lidhen në rrjet kabllor dhe ate radio me qëllim aplikimin e politikave të sigurisë.

Per të rritur kapacitetet dhe funksionalitetet zgjidhja teknike duhet të perfshije pajisjet e rrjetit të cilat duhet të sigurojne kapacitetet fizike të nevojshme për të mundesuar lidhjen e përdoruesave me pajisje mobile sic jane laptop, celular, etj. Pikat e aksesit radio do të sherbejne si ure lidhese midis pajisjeve mobile dhe rrjetit kabllor apo infrastrukturës së brendshme LAN. Ndërfaqet radio të tyre duhet të mundësojnë të dy bandat e frekuencave 2,4GHz dhe 5GHz për të suportuar standartet e reja të transmetimit të te dhënave sic jane 802.11n/ac/ax si edhe ato të vjetra sic jane 802.11b/g. Gjithashtu, pikat e aksesit radio duhet të mundësojnë ndërfaqe ethernet me protokollin Power over Ethernet, me qëllim për të lehtësuar lidhjet me rrjetin fizik duke shmangur përdorimin e Power Injector dhe lidhjen nëpër priza elektrike. Ndërfaqet radio për pikat e aksesit radio duhet të suportojne konfigurimin dhe trafikun nga disa identifikues sherbimi njekohesisht.

Zgjidhja teknike për rrjetin e aksesit radio duhet të jete e menaxhueshme nga nje sistem qendror ku administratoret e rrjetit të mund të aplikojne funksione sic jane konfigurimet, monitorimet, aplikimet e politikave të trafikut dhe sigurisë së rrjetit radio. Kjo zgjidhje duhet të siguroje menaxhim të burimeve radio të pikave të aksesit sic jane fuqia e sinjalit dhe kanaleve radio me qëllim optimizimin dhe krijimin e nje ambienti radio sa me efektiv dhe me performancë të lartë. Gjithashtu, zgjidhja teknike e ofruar duhet të menaxhoje funksionet e sigurisë në ambientin radio të tilla sic jane detektimi i pikave të aksesit radio të huaja të cilat interferojne me rrjetin lokal, mbrojtje nga nderhryjet keqdashese në ambientin radio, enkriptimin e trafikut të sinjalizimit midis pikave të aksesit dhe radio kontrollerit. Autentifikimi i përdoruesave në rrjetin radio mund të behet me ane të mekanizmave lokale të kontrollerit ose integrimin me nje sistem AAA të jashtem i cili i ofron keto mekanizma në nje nivel me të avancuar. Zgjidhja teknike duhet të mundësojë funksionet e ruajtjes së log-eve si edhe të siguroje informacion mbi statusin e rrjetit radio me ane të dashboard

dhe funksioneve analitike. Zgjidhja teknike duhet të bazohet mbi nje infrastrukturë të shtreses së dyte të modelit OSI e cila duhet të ketë si rol kryesor nderlidhjen e të gjithë pikave të aksesit radio me infrastrukturën e rrjetit LAN. Zgjidhja teknike duhet të ketë pajisje me funksione të shtreses së dyte të rrjetit dhe suport për PoE.

Gjithashtu zgjidhja teknike duhet të kene ndërfaqe uplink-e redundante me qëllim nderlidhjen e pajisjeve me pjesen ekzistuese të rrjetit sic mund të jenë switchet qendror ose ato të Agregimit. Zgjidhja teknike duhet të mundësojë kapacitete të mjaftueshme për të garantuar kalimin e trafikun drejt dhe nga rrjeti radio pa ndikuar në performancën dhe cilesine e sherbimeve.

7.1. Funksionalitete dhe bllokskema të infrastrukturës

Per të permbushur objektivin dhe qëllimet e projektit, duhet të ofrohet nje zgjidhje teknike e cila do të perfshije produktet me funksionet e mëposhtme si dhe konfigurimet përkatëse për të mundesuar keto funksione.

7.2. Kërkesat funksionale për zgjidhjen teknike mbi kontrollin e aksesit në rrjet

1. Zgjidhja duhet të mbështesë vertetimin e pajisjes dhe të përdoruesit duke përdorur protokollin standard IEEE802.1X dhe të pakten metodat e mëposhtme të Protokollit të Zgjerueshem të Autentifikimit: EAP-MD5, EAP-TLS, PEAP, EAP-FAST.
2. Zgjidhja duhet të siguroje komunikim me pajisjet e tjera të rrjetit duke përdorur protokollet e sigurisë sic jane RADIUS dhe TACACS.
3. Zgjidhja duhet të mbështesë vertetimin e përdoruesit dhe pajisjes duke përdorur bazat e të dhënave të mëposhtme:
 - a. Baza e të dhënave lokale të përdoruesve,
 - b. Baza e të dhënave lokale të pajisjes,
 - c. Serveri i jashtem RADIUS,
 - d. Serveri i jashtem LDAP,
 - e. Drejtoria e jashtme aktive e Windows,
 - f. Certifikatat dixhitale
4. Zgjidhja duhet të mbështesë integrimin e plotë me bazen e të dhënave të drejtorise aktive për të kryer funksionin “Sign-On”. Emri i përdoruesit dhe fjalekalimi i përdorur në vertetimin e Windows duhet të perdoren gjithashtu për kontrolle të tjera aksesi pa pasur nevoje të rifuten serisht.
5. Zgjidhja duhet të mbështesë vertetimin e përdoruesit nëpërmjet portalit HTTPS duke e ridrejtuar automatikisht përdoruesin.
6. Zgjidhja duhet të mbështesë vertetimin specifik të pajisjes 802.1x sipas adresave fizike MAC ose metodave të pershtatshme. Zgjidhja duhet të mbështesë nje baze të dhenash të brendshme që regjistron adresat MAC të pajisjes përmes nje procesi automatik të zbulimit të pajisjes.
7. Zgjidhja duhet të mbështesë vertetimin e certifikatave dixhitale sipas kritereve të mëposhtme:
 - a. Mbeshtetje për regjistrimin e të pakten dy CA-ve të jashtme
 - b. Mbeshtetje për shkarkimin e CRL (Lista e Revokimit të Certifikatave) nëpërmjet protokollit HTTP
 - c. Mbeshtetje për protokollin e verifikimit të statusit të protokollit OCSP

-
8. Zgjidhja duhet të mbështesë rregulla fleksibel të vertetimit në lidhje me zgjedhjen dhe renditjen e bazes së të dhënave ku do të kryhet vertetimi ose përdoruesi. Autorizimi duhet të sigurojë:
 - a. Caktim i VLAN
 - b. Mbeshtetje për krijimin e nje profili përdoruesi që të pakten duhet të perfshije:
 - Mbeshtetje për ndryshimin e autorizimit të protokollit RADIUS (CoA).
 - Mbeshtetje për autorizimin e protokollit TACACS të aksesit në pajisjet e rrjetit
 9. Zgjidhja duhet të sigurojë menaxhimin e llogarive të perkohshme të përdoruesve - Vizitore / Konsulentet. Krijimi i llogarive të perkohshme të përdoruesve duhet të mbështesë profile të ndryshme me privilegje të ndryshme, të pakten si me poshtë:
 - Profili i vizitorit vetëm me qasje në internet HTTP
 - Profili i konsulentit me akses HTTP vetëm në internet dhe intranetAdministratori i llogarive të përdoruesve mund të percaktojë fillimin dhe përfundimin e vlefshmerise për secilen llogari të perkohshme individualisht.
 10. Zgjidhja duhet të mbështesë krijimin e grupeve të shumta të autorizimit me privilegje të ndryshme për krijimin e porosive të perkohshme - me privilegjet e mëposhtme:
 - Krijimi i shume porosive të rastesishme
 - Import i skedarit të llogarise në formatin “.csv”
 - Dergimi i kredencialeve me email dhe SMS
 - Mundësia për të pare fjalekalimin e llogarise së perkohshme
 - Printim i detajeve të porosive të perkohshme
 - Menaxhim i porosive nga të gjitha grupet për autorizimin e porosive të perkohshme
 - Menaxhim i porosive nga i njeiti grup për autorizimin e porosive të perkohshme
 - Pezullimi i urdhrave nga të gjitha grupet për autorizimin e urdhrave të perkohshem
 - Caktimi i nje profili aksesi në rrjet me nje llogari të vizitorit
 - Caktimi i nje profili kohor për të hyre në llogarine e vizitorit
